



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



**Emërtimi i lëndës:** *Morfologji e Gjuhës B*

**Titullari / pedagogu i lëndës:** *Dr. Etleva Kondi, Dr. Hatixhe Sejdini*

**Ngarkesa:** *4 kredite; 40 orë mësimore; 20 leksione /20 seminare*

**Viti akademik/Semestri kur zhvillohet:** *2023-2024/ Viti I / Semestri II*

**Lloji i lëndës:** *Lëndë e detyruar*

**Programi i studimit:** *Bachelor në gjuhë angleze*

**Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës:**

[etleva.kondi@unitir.edu.al](mailto:etleva.kondi@unitir.edu.al), [hatixhe.sejdini@unitir.edu.al](mailto:hatixhe.sejdini@unitir.edu.al)

**OBJEKTIVAT E LËNDËS DHE REZULTATET E TË NXËNIT:**

***Objektivat e përgjithshme lëndore:***

Ky kurs synon të:

- ndërgjegjësojë studentët në përdorimin e saktë të formave gramatikore të gjuhës angleze
- të mundësojë konsolidimin e njohurive gramatikore të fituara e t'i lartësojë ato nga pikëpamja cilësore,
- të aftësojë studentët për të bërë përgjithësime teorike të domosdoshme për një specialist në këtë fushë.

Pasi studenti njihet dhe praktikon çështjet e trajtuara në modulën e “Morfologjisë së Gjuhës B”, kjo nëpërmjet teroisë së trajtuar gjatë leksioneve dhe seminareve të cilat mëshojnë në zbatimin dhe praktikimin e çështjeve gramatikore të trajtuara, atij i kërkohet që të demonstrojë informacionin e përfutur nëpërmjet përmbushjes së detyrave që i ngarkohen nga pedagogët.

Studenti, në përfundim të kësaj lënde, duhet të:

- kuptojë natyrën e veçantë të morfologjisë
- të jetë i aftë të aplikojë njohuritë e përfutura
- të njohë llojet e ndryshme të fjalëformimit në gjuhën angleze dhe strukturat gramatikore të pjesëve të ligjëratës

të shpjegojë dhe përdorë saktë strukturat përkatëse të pjesëve të ligjëratës të trajtuara

***Rezultatet e të nxënit:***

Lënda “Morfologji e gjuhës B”, trajton formën e fjalës dhe pjesët e ligjëratës. Programi i lëndës mbulon pjesët e ligjëratës si emri, folja, mbiemri, ndajfolja dhe parafjala si dhe strukturat kryesore të tyre. Një vëmendje e veçantë u kushtohet dhe problemeve kryesore që hasen me këto pjesë të ligjëratës dhe strukturave të tyre si p.sh. problemet me kohët e foljeve, parafjalët që ndjekin foljet, emrat, mbiemrat etj.

Nëpërmjet trajtimit të problemeve themelore, duke përdorur si metodë përfaqshen midis formave

e përdorimit të tyre në të dyja gjuhët (angleze e shqipe), programi synon të ndihmojë në formimin e dijeve të shëndosha tek studentët.